



Integriteti dhe besimi në zgjedhjet në Shqipëri duke nxitur transparencën e financimit të partive politike dhe siguria në përdorimin e teknologjisë së komunikimit dhe informimit.

IDEA - Prezantim i projektit

Tiranë më 22.06.2022

Të nderuar pjesmarrës

(1)

Dua ta them që në krye të kësaj fjale se do të ketë gjithmonë vend për të diskutuar e debatuar për financimin e partive politike, fushatave zgjedhore, apo në tërësi për raportin e politikës me paranë.

Ky diskutim dhe ky lloj debati nuk ka për të patur fund asnjëherë.

Nuk do të ketë fund edhe atëherë kur rregullimi i raportit para-politikë do të na duket si i plotë dhe i qartë.

Zhvillimet dhe ndryshimet ekonomike, politike e shoqërore edhe kur këto janë për mirë, passjellin gjithmonë nevojën për përshtatshmëri të rregullave për financimin e partive politike, të fushatave zgjedhore, apo në përgjithësi të financimit të veprimtarisë politike në vend.

Ndaj, është me dobi që herë pas here aktorë të ndryshëm politik dhe jo të tillë të përfshihen në këto diskutime dhe të vendosin më pas për zgjidhjen më të mirë në raport me realitetin e rastit.

Mbështetur sikur edhe vetëm mbi këtë argument, apo opinion, e konsideroj me dobi edhe këtë diskutimin e sotëm, si dhe iniciativën e IDEA për të punuar me aktorë të ndryshëm në Shqipëri për përmirësime të mundëshme të sistemit të financimit të politikës.

KQZ ka interesin dhe vullnetin për të kontribuar në këtë projekt, i cili nuk është dhe besoj nuk do të ngelet vetëm brenda IDEA-s.

(2).

Pikëpamja jonë është se në përgjithësi çështja e financimit të partive politike, apo edhe e fushatave zgjedhore është e rregulluar.

Nuk ka qenë kështu gjithmonë. Por ajo ka ardhur në standardin ku jemi sot nëpërmjet ndryshimeve përmirësuese të vazhdueshme.

Me ndryshimet e bëra në fundin e vitit 2020, të paktën formalisht, kuadri rregullator mbi financimin e partive politike dhe fushatave, mundet të konsiderohet i plotë në kuptim të:

- a) *Kush i financon partitë dhe fushatat e tyre (kush ka të drejtë tu japë para atyre)?*
- b) *Cilat janë limitet e financimit dhe ndalesat?*
- c) *Cili është organi përgjegjës për kontrollin/mbikqyrjen e financimeve. Si realizohet ky proces?*

Sipas legjislacionit tonë në fuqi partitë politike dhe kandidatëve mundet të marrin financime vetëm nga:

- a) *Personat fizikë dhe juridikë vendas, jo publik;*
- b) *Buxheti i shtetit;*
- c) *Aktiviteti i vetë partisë.*

Legjislacioni ynë e ndalon financimin nga shtete të huaja, apo nga persona juridik ose fizik të huaj.

Në legjislacion janë të përcaktuara edhe kufizimet në lidhje me masën e financimit.

Legjislacioni ka përcaktuar gjithashtu edhe organin përgjegjës për mbikqyrjen dhe kontrollin e financimit të partive politike në fushatë dhe jo në fushatë.

Pra në pamje të parë duket se rregullimi është i plotë.

Dhe formalisht ai është i tillë.

Kjo sepse në përputhje me standartet më të mira në lidhje me sistemin e financimit të politikës, ne e kemi të përcaktuar kush financon, sa financon dhe kush kontrollon.

Por besoj se nuk është tamam kështu.

(3)

Bazuar më së paku në një perceptim të fortë e të gjerë publik, duket se nuk ka një transparencë të plotë mbi kush financon kë, sa dhe si.

Ndaj ngelet pyetja: a ka vend për përmirësime të mëtejshme të këtij sistemi.

KQZ mendon se po .

Më së pari mendoj se vetë kuadri rregullator ligjor ka nevojë për plotësime dhe qartësime në lidhje me financimin e partive dhe të fushatave zgjedhore. Në disa takime të fundit me aktorë të ndryshëm politik, por edhe jo të tillë ka zënë vend pikëpamja se duhet të rregullohet financimi i të ashtuquajtur “palë të treta”. Pra të subjekteve të ndryshëm, jo parti politike, jo kandidatë, të cilët nuk marrin pjesë direkte në fushatë, por angazhohen në një mënyrë apo në një tjetër në to.

Gjithashtu, duhet të përfshihen në monitorim edhe financimet për partitë dhe fushatat e tyre në median e shkruar, si dhe në rrjetet sociale, apo në përgjithësi në internet.

Sot, raportimi i partive është thujse tërësisht formal dhe monitorimi dhe verifikimi nga KQZ ngelet vetëm brenda kuadrit të verifikimit formal dhe sipërfaqësor të asaj çfarë vetë partitë raportojnë. KQZ nuk ka sot thujse aspak autorizime ligjore për të shkuar më thellë në vërtetimin e përmbajtjes së raporteve që paraqiten nga partitë.

Në lidhje me këtë po ju jap një shembull: *Një parti politike ka raportuar se ka marrë një dhurim nga një person juridik, apo fizik i caktuar, të cilit i lejohet ta bëjë dhurimin në fjalë. Por në realitet ky dhurues mundet të mos e ketë mundësinë financiare për ta bërë këtë dhurim. Ai figuron në listën e dhuruesve formalisht dhe vetëm sepse partia ka “shpërndarë” vlerën e dhurimit nga një subjekt i caktuar tek disa të tjerë të cilët në fakt nuk kanë dhuruar asgjë.*

A nuk do të ishte e udhës në këtë rast që KQZ të kërkonte informacion nga zyrat tatimore, apo ILDKPKI, apo ndonjë zyrë tjetër, një informacion i cili do të konfirmonte, ose jo, mundësinë financiare të këtij dhuruesi për të bërë dhurime?

Mendoj se KQZ duhet t’i jepen më shumë autorizime ligjore, që në kushte caktuara ky institucion të kërkojë informacione shtesë nga partitë, apo kandidatët, apo edhe nga subjekte të

tjerë institucional ose jo, për të verifikuar mbi të dhënat në raportet financiare që paraqesin partitë, ose kandidatët.

(4)

Ndryshimet duhet të përfshijnë jo vetëm Kodin Zgjedhor por më së pari ligjin “Për partitë politike”. Kështu mendoj se partitë duhet të kenë detyrimin që në mënyrë periodike të bëjnë publike në radhë të parë anëtarësinë e tyre, e më pas çdo gjë që ka të bëjë me paratë që marrin dhe si i shpenzojnë ato.

KQZ-ja ka qenë e detyruar të bëjë auditimin e një numri të madh të partive politike të regjistruara në Regjistrin e Partive Politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Janë 131 të tilla. Të paktën sipas të dhënave që ne kemi.

Për më shumë se 50% prej tyre nuk ka asnjë informacion për adresat dhe kryetarin e partisë, të cilat pasqyrohen në regjistrin e Gjykatës.

Ligji “Për Partitë Politike” duhet të ofrojë një zgjidhje ligjore për këto rrethana. Partitë duhet të jenë të detyruara me ligj që, nëse ndryshojnë adresë, duhet të njoftojnë zyrtarisht KQZ-në brenda një afati të caktuar, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë partia apo nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga parti të caktuara duhet ti penalizojë ato deri edhe me mos regjistrimin në zgjedhje.

KQZ harxhon kohë, energji dhe financa për të gjetur adresat e këtyre partive dhe me shumë akoma për të bërë formalitetin e marrjes së raporteve dhe të vlerësimit të këtyre raporteve.

Janë rreth 80 parti që nuk kanë marrë pjesë në 4 zgjedhjet e fundit. Këto por edhe shumë të tjera nuk kanë përfituar fonde publike prej kohësh. Gjithashtu, nuk ka fare gjurmë të aktivitetit të tyre politik.

Pra nuk duket se ato ekzistojnë realisht.

Në vlerësimin tim, ligji duhet të ndryshojë për të vendosur prioritetë në kontrollin financiar të partive nga KQZ. Partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit, ato domosdoshmërisht duhet t'i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit financiar.

Në kushtet kur kapacitet e KQZ asnjëherë nuk do të jenë të tilla që në mënyrë kapilare të bëjë mbikqyrjen dhe kontrollin financiar të 131 partive, ligji duhet të parashikojë që ky institucion ti fokusojë burimet e veta njerëzore dhe financiare në parti që marrin pjesë në zgjedhje.

Për parti të tjera mbikqyrja dhe kontrolli financiar i tyre mundet të bëhet në kushte dhe kritere të tjera.

(5)

Ka edhe aspekte të tjera si të ligjit “Për partitë politike”, ashtu edhe të Kodit Zgjedhor që duhen rikonsideruar. Si të tilla por pa u limituar, janë ato që kanë të bëjnë me:

- kohën, kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së audituesve dhe/ose ekspertëve kontabël;
- raportimin nga kandidatët si ata të mbështetur nga parti politike (koalicion), ashtu edhe ata të mbështetur nga zgjedhësit;
- llojin dhe masën e sanksioneve, etj.

Për sa i përket KQZ, në përmbushje të përgjegjësisë së tij në kuadër të mbikqyrjes, kontrollollit dhe transparencës mbi financimin e partive politike, ne po punojmë të përmirësojmë nga çdo aspekt nga pikëpamja metodologjike dhe teknike të punës tonë.

Synojmë që të vendosim një standard në uniformizimin e raporteve financiare, kohës së paraqitjes së tyre, formës, mënyrës etj.

Po punojmë për të dixhitalizuar sa më shumë që të jetë e arsyeshme dhe e mundëshme sistemin e raportimit dhe të kontrollit nëpërmjet ndërtimit të moduleve të ndryshëm të cilët do të mundësojnë informimin real të publikut mbi financimin e partive dhe të fushatave.

Fokus do të ketë edhe në programet e trajnimit jo vetëm të audituesve dhe ekspertëve, por edhe të vetë kandidatëve, personave që merren me përgatitjen e raporteve, medias, etj.

Gjithë qëllimi është që informacioni mbi, sa para marrin partitë, apo kandidatët, nga kush i marrin, si i shpenzojnë ato, të jetë i plotë, në kohë reale. Të jetë sa më transparent.

Për ta përfunduar, por jo për nga rëndësia, KQZ falenderon IDEA, por edhe partnerë të tjerë për mbështetjen që i kanë dhënë dhe do ti japin në të ardhmen këtij institucioni për të përmbushur sa më mirë një nga përgjegjësit e tij ligjore më të rëndësishme në kuadër të administrimit të zgjedhjeve.

FALEMINDERIT

